

Broshurë teknike

PS-21

Ngopës me material rezistent ndaj ujit me bazë Silani/Siloksani që nuk përmban tretës

Përshkrimi

PS-21 është një solucion me bazë silani/siloksani, pa tretës dhe i gatshëm për përdorim për hidroizolim e nënshtresave inorganike.

- Ai ofron largim të shkëlqyer të ujit.
- Është i përshkueshëm nga avujt, duke lejuar “frymëmarrjen” e strukturës.
- Nuk formon cipë mbi sipërfaqen e aplikimit dhe nuk e ndryshon paraqitjen e saj.
- Mbron sipërfaqen nga formimet e kripërave ose nga ndikimet e ngricës ose të pislëqeve, sepse pengon thithjen e ujit të shiut ose të papastërtive.
- Është i përshtatshëm për nënshtresa shumë alkaline.
- Është shumë efikas pas përdorimit.
- Mbron nga karbonizimi.
- Është i përshtatshëm për nënshtresa me pak lagështirë.

Çertifikuar sipas standarteve EN 1504-2 dhe klasifikuar si një ngopës hidrofobik (kundër ujit). I shënuar me CE.

Fushat e përdorimit

PS-21 përdoret për mbrojtjen e sipërfaqeve vertikale ose horizontale nga ndikimi i shiut dhe për hidroizolim e fugave të pllakave. Ai është gjithashtu i përshtatshëm për hidroizolim e gurëve natyralë, të suvasë, tullave të ekspozuara, tjegullave të çatisë, të betonit të ekspozuar etj. Ai mund të përdoret gjithashtu mbi sipërfaqet e palëmuara të sipërfaqeve të mermerit për t'i mbrojtur ato nga thithja e ujit dhe e papastërtive. Mund të përdoret edhe në nënshtresa me pak lagështirë.

Të dhënat teknike

Ngjyra: transparent kur thahet
Densiteti: 0,99 kg/litër
Thellësia e depërtimit: Klasa I < 10 mm

Përthithja e ujit dhe

rezistenca ndaj alkalineve: (EN 13580) Shkalla e përthithjes <7,5% krahasuar me mostra të papërpunuara

Shkalla e përthithjes <10% pas zhytjes në solucion alkaline

Koeficienti i shkallës së tharjes: (EN 13579)

Klasa II >10%

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtresa

Sipërfaqet ku do të aplikohet PS-21 duhet të kenë pore të hapura dhe të jenë të pastra.

2. Përdorimi

a) Sipërfaqet horizontale

Në rastin e sipërfaqeve horizontale me aftësi thithëse (pllaka thithëse, mozaik etj.) aplikimi mund të bëhet me një kruajtëse.

Materiali lihet të veprojë për 5 minuta dhe pastaj materiali i tepërt hiqet duke përdorur një gërryese me shirit gome dhe sipërfaqja pastrohet me një leckë paksa të lagësht. Pastrimi përfundimtar i sipërfaqes mund të bëhet pas 6 orësh. Hidroizolimi është më efikas në sipërfaqet e pjerrëta dhe që nuk mbajnë ujë.

b) Sipërfaqet vertikale

Në sipërfaqe vertikale, PS-21 aplikohet nëpërmjet spërkatjes, furçës ose rullit. Zakonisht një ose dy duar janë të mjaftueshme. Dora e dytë bëhet ndërkohë që dora e parë është ende e freskët. Ngopja më e mirë arrihet në nënshtresa thithëse të thata ose paksa të lagështa.

c) Hidroizolimi i fugave të pllakave

Aplikimi i PS-21 për hidroizolim e fugave të pllakave mund të bëhet me anë të furçës ose të gërryeses me shirit gome.

d) Imprenjim

PS-21 mund të përdoret gjithashtu për ngopjen e materialeve të ndërtimit, si pllakat, tullat etj., i holluar me ujë në raporte 1:1 deri në 1:4.

PS-21

Konsumi

0,2-0,4 litër/m², në varësi të aftësisë thithëse të sipërfaqes.

Amballazhimi

PS-21 ofrohet në bidonë plastikë 1 litër, 5 litra dhe 20 litra.

Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim në bidonë të izoluar dhe në ambiente të freskëta për ruajtje është minimumi 24 muaj.



ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece

12

EN 1504-2

DoP No. PS-21/1411-02

surface protection products
hydrophobic impregnation

Depth of penetration: Class I < 10 mm

Water absorption and resistance to alkali:

- Absorption ratio < 7.5% compared to the untreated specimen,
- Absorption ratio < 10% after immersion in alkali solution

Drying rate: Class II > 10%

Dangerous substances comply with 5.3

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 576 029

www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu